



Prishtinë: 30.10.2009
Kodi i ZRRE-së: V_208_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
3. Kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit, të datës 27 korrik 2009,

në seancën e mbajtur më 30 tetor 2009 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **I lejohet** KOSTT SH.A. derogimi në zbatimin e dispozitave të disa neneve të **Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licenca e Operatorit të sistemit të Transmisionit** si në Shtojcë të këtij vendimi.
2. Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licenca e Operatorit të sistemit të Transmisionit të do të mbesin në fuqi.

ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 28 korrik 2009 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licenca e Operatorit të sistemit të Transmisionit. Gjatë vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të sistemit të transmisionit, ZRRE ka pa të arsyeshme që të lejohet derogimin në afatet e vendosura si në shtojcë.

Për raste të reja derogimi përfshinë afatet nga dita e aplikimit për derogim, ndërsa për rastet kur është lejuar derogimi më parë, afati vlen nga data e skadimit të derogimit paraprak.

3. Vendimi nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



5. Vendimi hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca - Derrogimet e lejuara;

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar